



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 11/13 DATË 18 / 07 /2022

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 11/6 DATË 04.02.2021 TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE "PËR MIRATIMIN E STATUSIT "INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË" PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT "PARKU ME ERË" ME SUBJEKT APLIKUES "BIOPOWER GREEN ENERGY" SH.P.K. ME NIPT/NUIS K72405024M DHE "MARSEGLIA GROUP" SRL CF00695260604"

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18 dhe 22 të Ligjit Nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 "Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike", Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Komiteti i Investimeve Strategjike me Vendimin Nr. 11/6 datë 04.02.2021, ka vendosur:
 - *Miratimin e Statusit "Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë" për projektin e investimit "Parku me erë".*
 - *Projekti "Parku me erë" do të realizohet nga subjekti "BIOPOWER GREEN ENERGY" SH.P.K. ME NIPT/NUIS K72405024M dhe "MARSEGLIA GROUP" SRL CF00695260604.*
 - *Projekti parashikon ndërtimin e dy parqeve me erë, të quajtura BPGE1 dhe BPGE2, në kreshtat e dy maleve në Bashkinë e Lezhës, të cilat do të jenë të afta të gjenerojnë 234 MW dhe do të zhvillohet në një sipërfaqe prej 100 HA, në vargmalet e Rencit dhe Kakariqit, të vendosura paralel me vijën bregdetare në Shëngjin dhe Balldren, Lezhë, ku:*

a) Parku i parë është afër portit të Shëngjinit, i vendosur përgjatë drejtimit SE-NO, dhe zhvillohet në një lartësi mbi nivelin e detit duke filluar nga 241.00 m në 545.00 m me fuqi 114 MW ;

b) Parku i dytë ndodhet në bregdet, paralel me të parën, dhe zhvillohet në një lartësi mbi nivelin e detit midis 200/350 m s.l.m, me fuqi 120 MW .

- Projekti i investimit nuk ka filluar ende implementimin e tij.
- Subjekti Investues ka paraqitur pranë AIDA-s, kërkesë për ndryshimin e Vendimit të KIS Nr. 11/6, datë 04.02.2021, duke kërkuar heqjen, si investitor të shoqërisë "Biopower Green Energy" sh.p.k. me NIUS K72405024M, dhe zëvendësimin e saj me shoqërinë "Marseglia Green Energy" sh.p.k., me NIUS M11803021H.
- "Marseglia Group" S.p.A. ka krijuar shoqërinë e re "Marseglia Green Energy" sh.p.k., me NIUS M11803021H, në pronësi të plotë të shoqërisë "Ital Green Energy Holding" SRL, me 100% të kapitalit të saj.
- Me krijimin e shoqërisë "Marseglia Green Energy" shpk, shoqëria "Biopower Green Energy" sh.p.k ia ka transferuar të gjitha asetet, të drejtat dhe detyrimet shoqërisë së re. Në këtë mënyrë, "Marseglia Group" S.p.A, bëhet pronar i vetëm i të dy shoqërive, duke ritheksuar se mbështet, po njësoj, projektin e investimit strategjik për të cilin ka përfituar statusin e investitorit/investimit strategjik edhe me shoqërinë e re "Marseglia Green Energy" sh.p.k.
- Shoqëria e re "Marseglia Green Energy" sh.p.k., me NIUS M11803021H, është krijuar me qëllimin e posaçëm/veçantë në funksion të zbatimit të projektit të investimit strategjik, në përputhje me kërkesat e pikës 6 të VKM-së Nr. 1028, datë 16.12.2015 "Për përcaktimin e marzheve, rregullave dhe dokumentacionit të garancive financiare të investimeve strategjike".
- Sikurse përcakton VKM Nr. 1028, datë 16.12.2015, dokumentacioni, në lidhje me kapacitetet financiare, është paraqitur nga shoqëria zotëruese e Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV).
- Subjekti është informuar që në krye të herës se duhet të rishikojë projektin teknik të investimit duke spostuar turbinat që prekin në zonë të mbrojtur.
- Gjithashtu, bazuar në verifikimet e kryera edhe nga vetë subjekti, rezulton edhe se, një sipërfaqe toke, në të cilin ishte parashikuar të pozicionohej turbina W TG 36, e që deri para pak kohësh ka pasur statusin juridik "Shtet", në muajin Tetor 2021 është regjistruar si pasuri "private".
- Për sa më sipër, subjekti investues konfirmon angazhimin se do të heqë prej projektit turbinat në fjalë, por, për të mos ulur kapacitetin prodhues, do të shtojë kapacitetet në turbinat e mbetura. Në përfundim, të dy parqet me erë, do të vazhdojnë të jenë të afta për

të gjeneruar 234 MW .

- Ndërkohë, aktualisht kërkohet nga KIS që të bëhet një ndryshim tek vendimi i mëparshëm ku të zëvendësohet subjekti "Biopower Green Energy" sh.p.k. me NIUS K72405024M me shoqërinë "Marseglia Green Energy" sh.p.k., me NIUS M11803021H.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Titulli i Vendimit Nr. 11/6 datë 04.02.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) ndryshohet si më poshtë vijon:

"Për miratimin e statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë" për projektin e investimit "Parku me erë" me subjekt aplikues shoqëria "Marseglia Green Energy" sh.p.k., me NIUS M11803021H "dhe "Marseglia Group" S.p.A, CF00695260604"

2. Pika 1 e Vendimit Nr. 11/6 datë 04.02.2021 të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) ndryshohet si më poshtë vijon:

"Miratimin e statusit "Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Veçantë" për projektin e investimit "Parku me erë" me kushtin e zhvillimit dhe finalizimit të disa proceseve nga subjekti investues dhe institucionet e përfshira në vlerësim."

3. Pika 2 e vendimit ndryshon si më poshtë vijon:

"Projekti "Parku me erë" do të realizohet nga shoqëria "Marseglia Green Energy" sh.p.k., me NIUS M11803021H "dhe "Marseglia Group" S.p.A, CF00695260604".

4. Pas pikës 5 të vendimit, shtohet pika 5/1, si më poshtë:

"5/1 Afati 2 (dy) vjeçar i statusit strategjik, fillon nga njoftimi i këtij vendimi investitorit, nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve."

5. Pas pikës 15 të vendimit, shtohet Pika 15/1 dhe Pika 15/2, si më poshtë:

"15/1 Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) që brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, të vërë në dispozicion të projektit të investimit, kufijtë realë të gjurmës së saktë dhe koordinatat përkatëse të shtrirjes së Peizazhit të Mbrojtur (PM) "Lumi Buna - Velipojë"."

"15/2 Ngarkohet subjekti investues, që brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njohja me kufijtë realë të gjurmës së saktë dhe koordinatat përkatëse të shtrirjes së Peizazhit të Mbrojtur (PM) "Lumi Buna - Velipojë, të paraqesë pranë Sekretariatit Teknik të KIS projektin e përditësuar teknik të investimit, ku të reflektohet heqja e turbinave nga zona e mbrojtura dhe ruajtja e parametrave të veçantë të projektit, lidhur me kapacitetin prodhues. Në rast të mosrespektimit të këtij kushti, Komiteti i Investimeve Strategjike ka të drejtë të

revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.

6. Pika 16 e vendimit ndryshon si më poshtë:

"Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorimin e realizimit të planit të veprimit të projektit të investimit."

7. Pas pikës 16 të vendimit shtohet pika 17, si më poshtë:

"17. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike, në asnjë rast nuk do të konsiderohet investim, qoftë sipas kuadrit vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar, në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se miraton në parim realizimin e një projekti investimi, materializimi i të cilit do të bazohet në përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve që parashikojnë legjislacionet sektoriale në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

FRIDA KRIFCA

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

SOKOL NANO